VENDIM
Nr. 244, datë 24.4.2019

PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE TË FUNKSIONIMIT TË KËSHILLIT DREJTUES TË AGJENCISË SHTETËRORE TË KADASTRËS DHE PËR MASËN E SHPËRBLIMIT PËR VEPRIMTARINË E ANËTARËVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, dhe të pikës 2, të nenit 8, të ligjit nr. 111/2018, "Për kadastrën", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITË E PËRGJITHSHME

1. Objekt i këtij projektvendimi është përcaktimi i rregullave të funksionimit të këshillit drejtues të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, përcaktimi i rasteve të mbarimit të mandatit dhe të shkarkimit të anëtarëve, si dhe të masës së shpërblimit financiar të anëtarëve dhe të sekretariatit teknik.

II. ANËTARËT DHE KRYETARI

2. Anëtarët e këshillit drejtues të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, në vijim (ASHK), gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre, udhëhiqen nga parimet e përcaktuara në Kodin e Procedurave Administrative dhe në nenin 5, të ligjit nr. 111/2018, "Për kadastrën".

3. Mandati i anëtarit të këshillit drejtues të ASHK-së mbaron:

a) kur jep dorëheqjen;

b) kur përfundon mandati 4-vjeçar i qëndrimit në detyrë;

c) kur mbush moshën e pensionit;

ç) në rast vdekjeje të tij.

4. Rastet e shkarkimit të anëtarëve të këshillit drejtues janë, si më poshtë vijon:

a) kur ndërpret marrëdhëniet e punës me institucionin që përfaqëson;

b) kur zëvendësohet, sipas diskrecionit të institucionit propozues dhe të Këshillit të Ministrave;

c) kur dënohet me vendim penal të formës së prerë;

ç) kur bëhet i paaftë mendërisht ose fizikisht për të ushtruar detyrën;

d) kur nuk merr pjesë në mbledhjet e këshillit drejtues, më shumë se 3 herë radhazi.

dh) kur me veprimet e tij dëmton veprimtarinë e këshillit drejtues.

5. Në rast vakance në pozicionin e anëtarit të këshillit drejtues, ASHK-ja, brenda 5 (pesë) ditëve nga konstatimi i vakancës, njofton institucionin përkatës për propozimin e anëtarit të ri. Institucioni propozues duhet t'i përcjellë Këshillit të Ministrave anëtarin e ri, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga njoftimi i ASHK-së.

6. Zgjedhja e kryetarit të këshillit drejtues bëhet sipas përcaktimeve të pikës 1, të nenit 8, të ligjit nr. 111/2018, "Për kadastrën". Kohëzgjatja në detyrë e kryetarit është 2 vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.

III. MBLEDHJET DHE VENDIMMARRJA

7. Këshilli drejtues mblidhet, si rregull, çdo muaj, si dhe sa herë që kërkohet nga drejtori i Përgjithshëm i ASHK-së, sipas nevojave të Agjencisë.

8. Mbledhja e këshillit drejtues është e vlefshme nëse në të janë të pranishëm, të paktën, katër anëtarë.

9. Mbledhja e këshillit drejtues të ASHK-së drejtohet nga kryetari dhe, në rast mungese të tij, nga anëtari më i vjetër në moshë.

10. Vendimet merren me shumicë të thjeshtë të anëtarëve të pranishëm. Në rastet kur nga votimi nuk arrihet shumica, vendimmarrja përcaktohet nga vota e kryetarit.

11. Këshilli drejtues, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, asistohet nga sekretariati teknik, i përbërë nga 3 (tre) punonjës të ASHK-së, të caktuar nga drejtori i përgjithshëm.

IV. MASA E SHPËRBLIMIT

12. Kryetari i këshillit drejtues merr shpërblim mujor në masën 30 000 (tridhjetë mijë) lekë.

13. Anëtarët e këshillit drejtues marrin shpërblim mujor në masën 25 000 (njëzet e pesë mijë) lekë.

14. Anëtarët e sekretariatit teknik të këshillit drejtues marrin shpërblim mujor në masën 5 000 (pesë mijë) lekë.

15. Shpenzimet për shpërblimin e kryetarit, të anëtarëve dhe të sekretariatit teknik të këshillit drejtues, të cilat vërtetohen kundrejt dokumentit të pjesëmarrjes në mbledhje, përballohen nga buxheti i ASHK-së.

V. DISPOZITË E FUNDIT

16. Për çështjet që nuk janë të rregulluara posaçërisht në këtë vendim, funksionimi i këshillit drejtues i nënshtrohet rregullave të parashikuara në legjislacionin për organet kolegjiale të administratës shtetërore.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe